REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 5908/8 **Prot.** **Divjakë, më:** 14/07/**2026**

PROJEKT-VENDIM

Nr. 67, **datë** 14/07/**2026**

PËR
MIRATIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR NË PROGRAMIN "EMERGJENCAT CIVILE" PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 **"Për Vetëqeverisjen Vendore"** i ndryshuar, në ligjin nr.45/2019 **"Për Mbrojtjen Civile",** neni 23, pika 6, gërma (d), neni 30, gërma (f),(k) , në ligjin nr.87/2025 **"Për buxhetin e vitit 2026",** në VKM nr.414, datë 8.7.2021 **"Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"** pika 3.1, gërma (b), (e), dhe pikës 5, në shkresën nr.429/6 prot., datë 15.04.2026 të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, i propozojmë Këshillit Bashkiak të Bashkisë Divjakë,

1. Të miratoj përdorimin e fondit të kushtëzuar në programin "Emergjencat civile" për vitin 2026, me vlerë 4,352,189.9 lekë, për realizimin e projektit "Prita nivelngritëse në kulluesin kryeson K3-4" fshati Karavasta, Njësia Administrative Remas dhe fshati Babunjë, Njësia Administrative Gradishtë.
2. Punimet që do të kryhen për realizimin e këtij projekti janë sipas preventivit dhe projektit bashkëlidhur këtij projektvendimi.
3. Vlera e mbikqyrjes së punimeve është 113,157 lekë me tvsh.
4. Vlera e kolaudimit të punimeve të ndërtimit të objektit është 16,974 lekë me tvsh.
5. Burimi i financimit është nga fondi i kushtëzuar për vitin 2026, transferuar nga Ministria e Mbrojtjes, programi "Emergjencat civile", kodi i produktit AD.

Drejtori drejtorisë PZHT
Ardit Janko

KRYETARI

Josif GORREA

Përgjegjës sektorit juridik, prokurimeve publike dhe menaxhimit të aseteve
Andi Bullari

Drejtori drejtorisë financës dhe buxhetit
Xheladin Brahkola
P/ GB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DIVJAKË

Adresa: Sheshi "Santa Barbara" Divjakë, info@bashkiadivjake.gov.al